



Në vitin 2021 është vendosur që ish-biblioteka Hivzi Sulejmani në Prishtinë të përtërihet për t'u bërë një nga selitë qendrore të Manifesta 14. Ne besojmë se procesi i përtërirjes shkon përtej rinovimit të ndërtesave, ai sjell histori dhe tërheq vëmendjen në marrëdhëniet midis hapësirës dhe kujtesës.

Çfarë zgjedhim të mbajmë, të restaurojmë, të përtërijmë dhe të kujtojmë dhe çfarë vendosim të eliminojmë? Rregullimi i së kaluarës materiale të një ndërtese kërkon ballafaqim me të kaluarën jomateriale - shoqërinë, kulturën, vlerat dhe kujtimet. Është një proces interpretues dhe pjesëmarrës i vështrimit në të kaluarën për të zbuluar rrëfime që nuk mishërohen në një histori, kujtesë apo identitet të vetëm, por në një histori kumulative dhe të negociueshme.

Dokumentimi arkivor mbi historinë e bibliotekës ishte jashtëzakonisht i kufizuar dhe ne vendosëm t'i qasemi përtërirjes së hapësirës duke aktivizuar procese sociale siç është angazhimi me kujtesën e saj kolektive. Fondacioni Shtatëmbëdhjetë është ftuar të na ndihmojë në (ri)ndërtimin e këtyre njohurive duke eksploruar histori dhe kujtime të ndryshme të njerëzve që kanë punuar në institucion ndër vite, anëtarëve dhe vizitorëve të bibliotekës dhe qytetarëve të Prishtinës. Ky botim, formati i të cilit i referohet kartave të vjetra të anëtarësimit të bibliotekës Hivzi Sulejmani, është rezultat i hulumtimit të lartpërmendur i cili është kryer në vitin 2021. Ai shërbeu jo vetëm si një pikënisje për aktivitetet e ardhshme të programit të Edukimit dhe Ndërmjetësimit të Manifesta 14 në ish sallën e leximit të kësaj biblioteke, por edhe për konceptin artistik të Manifesta 14 për të kontekstualizuar një hapësirë të përhershme ndërdisiplinore që do të quhet Qendra për Praktikë Rrëfyese.

Kemi dëshirë që të falenderojmë Fondacionin Shtatëmbëdhjetë për këtë bashkëpunim dhe ekipën e hulumtimit: Bleona Kurteshi, Egzona Hajrullahu, Goneta Ademaj, Idila Ibrahim, Trina Hoti, Ridona Berisha, Lirika Demiri, mentorët e hulumtimit Linda Gusia and Nita Luci, si dhe autoren e raportit Sihana Klisurica.

PËRMBAJTJA:

HYRJE  
 METODOLOGJIA  
 PERSPEKTIVË E SHKURTËR HISTORIKE  
 POLITIKAT E EMËRTIMIT  
 KUJTESA KOLEKTIVE  
 AKTIVITETET  
 OAZA  
 BRAKTISJA (2016-2020)  
 E ARDHMJA

Objekti që ndryshe njihet si ish-biblioteka “Hivzi Sulejmani”, si institucion më vete bartë jo vetëm vlera edukuese e kulturore, por edhe të trashëgimisë kulturore. Si bibliotekë, në rolin e një hapësire, u mundësoi shumë brezave qasjen në literaturë të ndryshme në rrugëtimin drejt zhvillimit personal, ndërsa në aspektin arkitekturor mban vlera stilistikore e në vjetërsi kohore. Objekti ka arkitekturë rezidenciale të viteve '30 me ndikim të stilit austro-hungarez, i cili pavarësisht etapave të zhvillimit arkitektonik, por edhe të shkatërrimit si pasojë e luftërave, i ka mbijetuar kohës.

Duke analizuar ekzistencën e tij, gati njëshekullore, kuptojmë më qartë rolin e ndryshimeve politike dhe aspekteve sociale e kulturore në vend. Në këtë përmbledhje mëtohet të vihen në pah perspektiva të ndryshme nisur nga historiku i shkurtër i funksioneve të objektit, periudhën e themelimit të bibliotekës, shkëlqimin e këtij institucioni, sfidat dhe aktivitetet.

Një pjesë e madhe e këtij materiali bazohet në intervistat që kontribuojnë në mbledhjen e kujtesës kolektive rreth bibliotekës, e po ashtu në materiale të tjera arkivore dhe dokumente të gjetura në fazën katër-mujore të hulumtimit përgjatë vitit 2021.

Për të kuptuar aspekte më komplekse, ndërveprimet sociale apo edhe fenomenet kulturore, ky hulumtim na ndihmon të shqyrtojmë se si dhe përse kanë ndodhur gjëra të caktuara, duke interpretuar aktivitetet dhe duke përshkruar veprimtaritë të ndryshme.



Në mënyrë që të mblidhen të dhëna rreth eksperiencave të jetuara, emocioneve, sjelljeve dhe kuptimeve e përjetimeve individuale rreth ish-bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, është përdorur metoda kualitative e hulumtimit. Me këtë rast janë realizuar intervista me individë të cilët kanë punuar apo frekuentuar bibliotekën në kohë të ndryshme të jetës së tyre. Për të krijuar një pasqyrë më të gjerë të gjendjes së objektit dhe kujtimeve të përbashkëta që krijojnë narracionin e përgjithshëm, janë realizuar mbi 40 intervista gojore, ndërkaq janë hulumtuar edhe arkivat shtetërore e personale si materiale mbështetëse. Për hulumtim janë angazhuar gjashtë praktikante hulumtuese, të cilat kanë zhvilluar intervista me banorë të lagjes, persona që kanë punuar dhe ende janë aktivë në bibliotekë. Mostra prej mbi 40 intervistave, me persona të grupmoshave të ndryshme, prej 20 deri në 65+, ofron një ide të përgjithshme mbi funksionin e këtij institucioni ndër vite dhe dëshmon kujtesën kolektive rreth tij.

Gjithashtu për të mbështetur hulumtimin janë gjetur libra, raporte, kartela, revista, fotografi dhe materiale të tjera mbi të cilat bazohet ky raport.

Ndonëse nuk ekziston një dokument që dëshmon vitin e ndërtimit të objektit të ish-Bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, por mbështetur në mbishkrimin në fasadën ballore besohet se është ndërtuar në vitin 1930. Sipas monografisë së shkruar nga Sylejman Pireva – ish-drejtor i bibliotekës 1999 - 2008 – “objekti ishte pronë e një tregtari hebre me emrin Jovo (Jovan Miliq)”<sup>1</sup> i cili i ishte konfiskuar pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1945 aty ishte vendosur Komiteti Krahnor i Partisë Komuniste, derisa në vitin 1947 mori funksionin e bibliotekës të cilin e mbajti deri në vitin 2016. Biblioteka u vendos në këtë objekt dy vite pas themelimit, por nuk ka të dhëna se në cilën hapësirë ishte vendosur paraprakisht.

Ndër vite kjo bibliotekë pati emërtime të ndryshme, fillimisht si Biblioteka Popullore “Miladin Popović” deri në vitin 1993<sup>2</sup>, më pas Biblioteka grada (Biblioteka e Qytetit).

“Ndryshime të shpeshta në emërtimin e kësaj biblioteke ndodhin edhe më vonë, si p.sh. Biblioteka e Qytetit ‘Hivzi Sulejmani’, Biblioteka Rajonale ‘Hivzi Sulejmani’, si dhe Biblioteka Ndërkomunale ‘Hivzi Sulejmani.’”<sup>3</sup> Ky institucion tani bartë emrin Biblioteka “Hivzi Sulejmani.”

Janë katër periudha historike që e karakterizojnë punën e Bibliotekës “Hivzi Sulejmani”. Në periudhën e parë mes viteve 1947-1977, biblioteka po mëtonte të konsolidohej në një institucion të vetëm. Në dekadën e parë, kishte shumë pak punonjës dhe të gjithë ishin të pakualifikuar për pozitat e tyre. Në vitin 1956, kishte 12 punonjës – shtatë prej të cilëve ishin serbë, një shqiptar, një turk, dy roma, dhe një i/e huaj. Në mesin e viteve '60, biblioteka kishte rreth 60.000 libra – për dallim nga 1300 sa kishte kur u themelua - me më shumë se dy të tretën e tyre në gjuhën serbo-kroate.

Në vitin 1971, kishte rreth 5.000 anëtarë të etnive të ndryshme – serbë, shqiptarë, malazezë, turq dhe të tjerë. Në vitin 1975 biblioteka kishte 35 degë në gjithë Kosovën. Vlen të përmendet se biblioteka kishte edhe një koleksion lëvizës të librave që udhëtonte nëpër lokacione dhe institucione të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe vendet rurale, shkollat, spitalet dhe fabrikat që punësonin një numër të madh punonjësish.

Periudha e dytë 1977-1992 konsiderohet si një kohë në të cilën biblioteka njohu zhvillimin më të shpejtë. Përgjatë atyre viteve, më shumë shqiptarë u bënë pjesë e stafit të bibliotekës dhe në vitin 1977 për herë të parë pozitën e drejtorit e mbajti një person shqiptar, Zekie Kada, e cila qëndroi në këtë pozitë deri në vitin 1992. Milka Stefanovic, ishte drejtorja e parë e bibliotekës e cila mbajti pozitën prej vitit 1953 deri më 1959. Pas saj në pozitë do të vinte Radoslavka Gigiq, e cila ishte në pozitë mes viteve 1959 -1977. Të dyja të nacionalitetit serb.

Duke marrë parasysh se niveli i shkollimit në Kosovë ishte shumë i ulët pas Luftës së Dytë Botërore, me zhvillimin e vendit vërehet edhe rritje e dukshme e shtimit të popullsisë, njëkohësisht zbritje edhe numri i alfabetizimit. Kjo rritje dhe ky zhvillim arrin pikun në vitet '70.

<sup>1</sup> Sylejman Pireva, Biblioteka publike “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës (1945-2010), fq. 20, Prishtinë, 2011

<sup>2</sup> <https://www.biblioteka-pr.org/sq/Historiku>, shfletuar 09.03.2022

<sup>3</sup> Po aty

Derisa “prej regjistrimit të parë të pas LDB-së, të bërë në vitin 1948, deri tek i fundit në nivel të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të bërë në vitin 1981, numri i banorëve të Prishtinës është rritur nga 19.631 në 108.083 banorë.”<sup>4</sup> Një rritje e tillë ndikoi edhe në nevojën për akomodim më të madh të lexuesve. Salla e leximit, e cila u ndërtua më vonë në po të njëjtën hapësirë, në kuadër të bibliotekës, kishte kapacitet prej rreth 50 ulësesh. Aty ishte vendosur koleksioni i librave shkencorë. Kjo bibliotekë arriti që fondin e saj ta shtojë me tituj të ndryshëm gjatë kësaj periudhe, ku krahas librave për fëmijë, siguroi edhe literaturë botërore, romane e libra shkencorë në gjuhën shqipe, serbe, angleze e të tjera.

Periudha e tretë 1992-1999 u përkufizua nga zhvillimet e gjëra politike në Kosovë. Me suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitin 1989, do të pasonte pushtimi i Kosovës nga forcat serbe dhe njëkohësisht nisën masat represive ndaj qytetarëve shqiptarë në vend. Me largimin e shqiptarëve nga puna, krijimin e masave shtypëse në baza etnike, që kapitulloi me luftën në vitet 1998-1999, pasojat u vërejtën edhe në bibliotekë. Numri i librave, veçanërisht atyre në gjuhën shqipe u reduktua dukshëm dhe atmosfera në mes stafit të bibliotekës ishte e tensionuar. Fondi i bibliotekës gjatë kësaj periudhe pësoi humbje të mëdha, për shkak se një numër i konsiderueshëm i librave në gjuhën shqipe ishin dërguar në fabrikën e letrës në Lipjan për përpunim pasi që ishte formuar një komision për rishikim të librave të cilët konsideroheshin se ishin në kundërshtim me politikën serbe, derisa degët e bibliotekës jashtë Prishtinës, të 28-ta, u mbyllën.

<sup>4</sup> Arbër Sadiki, Arkitektura e Ndërtesave Publike në Prishtinë: 1945-1990, Faktorët shoqëror dhe formësues, 2020 Prishtinë, fq.22

Periudha e katërt përfshin vitet 1999-2016. Menjëherë pas luftës së fundit, biblioteka riktheu aktivitetet e veta duke hapur degë të reja, duke zgjeruar koleksionet e librave dhe duke rinovuar hapësirat. Në vitin 1999, biblioteka mori emrin “Hivzi Sulejmani”, në nder të shkrimtarit të njohur, i cili i dha Komunës së Prishtinës pronën e tij në lagjen Taslixhe për hapjen e një biblioteke për fëmijë. Në të njëjtën hapësirë gjendjet edhe shtëpia e tij. Busti i tij ishte ngritur në oborrin e bibliotekës në Tophane menjëherë në vitin 2000. Udhëheqës i bibliotekës u përzgjedh Sylejman Pireva i cili në tetë vitet që menaxhoi këtë institucion arriti të krijojë programe të ndryshme dhe bashkëpunime me biblioteka të tjera. Prej vitit 2008 pozitën e drejtorit e mori Munish Hyseni, pozitë të cilën e mban edhe sot.

Objekti i ish-Bibliotekës “Hivzi Sulejmani” në vitin 2011 u fut në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, ndërsa prej vitit 2016 mbeti i braktisur. Më 23 gusht të vitit 2016 u bë inaugurimi i objektit të ri në lagjen Dardania, ku edhe sot vepron ky institucion. Kështu duke lënë prapa objektin e vjetër 92-vjeçar, me shumë premtime e plane deri më tani të përealizuara për qëllimin e tij të ri.

Në një këndvështrim të gjerë të emërtimeve që biblioteka ka patur ndër vite, kuptojmë se në varësi të periudhës historike dhe rrethanave shoqërore, se cilat grupe të shoqërisë kanë qenë të favorizuara. Biblioteka kur filloi punën, mori emrin e Miladin Popoviqit (1910-1945). Ai ishte një partizan jugosllav, sekretar politik i Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe organizator i partisë Komuniste të Shqipërisë. I njëjti është vrarë në zyrën e tij në objektin ku më pas u vendos biblioteka, prej 1947 deri më 2016. Gjatë periudhës sa kishte emrin e Miladin Popoviqit, sidomos në dekadat e para, dominonin librat në gjuhën serbe, dhe prezenca e lexuesve të kombësisë serbe ishte më e dukshme.

Në vitin 1999, pas luftës në Kosovë, kur shqiptarët morën përsipër menaxhimin e institucioneve, biblioteka mori emrin e Hivzi Sulejmanit (1910-1975). Ai ishte shkrimtar i njohur shqiptar, tek vlerësohet si shkrimtari që vuri themelet e letërsisë shqipe në prozë. Sulejmani i takonte lëvizjes së majtë letrare dhe politike. Ajo që vërehet në kohën e viteve 2000, është gati e njëjta gjë që pati ndodhur në vitet '90. Derisa atëherë librat në gjuhën shqipe u ndaluan ose u dogjën, në periudhën e viteve 2000 ndodh e njëjta gjë me librat në gjuhën serbe. Këtë e dëshmon edhe fakti i hedhjes apo i lënies mbrapa të shumë botimeve në gjuhën serbe pasi që biblioteka u zhvendos në objektin e ri në vitin 2016. Botime të viteve 1800 e më tutje janë gjetur në objektin prapa objektit kryesor të ish-bibliotekës. Në procesin e inventarizimit, stafi kishte lënë pas libra të vjetër e historikë.



Megjithatë, njëjtë si figura e Miladin Popoviqit ashtu edhe ajo e Hivzi Sulejmanit shumë shpesh kanë ngjallur dhe vazhdojnë të ngjallin diskutime në mese të ndryshme shoqërore. Për Popoviq ka të tillë që e konsiderojnë hero, e të tjerë edhe tradhtar. Derisa Sulejmani vlerësohet për kontributin e tij si shkrimtar, por jo edhe për atë politik, pasi që në vitet '40 ai emërtohet kryetar i Gjykatës në Prizren, e më vonë në pozitën e Prokurorit Krahinor. Në janar të vitit 2021 Kuvendi Komunal në Prishtinë kishte diskutuar rreth kërkesës zyrtare të asambleistit të pavarur Rifat Deri që të bëhet ndërrimi i emrit të bibliotekës. Në një intervistë dhënë për gazetën Koha Ditore në janar të vitit 2021, Deri ndër të tjera kishte thënë se biblioteka nuk meriton që të ketë emrin Hivzi Sulejmani me arsyetimin se “ka qenë i përfshirë në procese që çuan në vrasjen e shqiptarëve.”

“Me rastin e hyrjes së fuqisë së pushtimit ushtarak të asaj kohe, ose orës policore ushtarake, emërtohet si gjykatës i Gjykatës në Prizren, ku dënon shumë shqiptarë me pushkëtim dhe me burgim të rëndë, vetëm e vetëm se nuk i takonin ideologjisë komuniste të asaj kohe”, kishte thënë Deri<sup>5</sup>. Por një gjë e tillë nuk u miratua.



<sup>5</sup> <https://www.koha.net/kulture/253970/nisma-per-heqjen-e-emrit-te-hivzi-sulejmanit-nga-biblioteka-ndan-letraret/>



“Nostalgji”, është fjala e parë të cilën gati të gjithë të intervistuarit/at përshkruajnë objektin e ish-bibliotekës “Hivzi Sulejmani”. Punë e rehatshme, punë që të jep kënaqësi, përmbushëse, janë vetëm disa prej përshkrimeve të tjera që pasojnë. Lidhja e ngushtë mes punonjësve, fondi i librave, larmishmëria e titujve dhe lidhja me lexuesit/et, përshkruhen si pikët kryesore dhe më të forta të tyre. Por nuk mbesin anash edhe ankesat. Vjetërsia e objektit dhe kushtet jo të mira të punës i kanë bërë shumë prej tyre prej vitesh të ëndërrojnë një hapësirë tjetër pune ku do të funksiononte ky institucion. Objekti 92 vjet i vjetër, bashkë me sallën e leximit të ndërtuar shumë vite pas tij, nuk i plotësonin kushtet e nevojshme për akomodim të lexuesve dhe aktiviteteve, sidomos në vitet e pasluftës në Kosovë. Kopshti i madh dhe plot gjelbërim ishte si një ikje nga dhomat, siç përshkruhen, të errëta të leximit.

Pavarësisht kësaj, vetë fakti se u angazhuan vullnetarisht që ta mirëmbajnë atë duke mbjellë e sjellë lule tregon familjarizimin dhe rehatinë që kishin në vendin e punës.

Në gusht të vitit 2016, biblioteka “Hivzi Sulejmani” u zhvendos në objektin e ri dhe Fatime Mehmetaj, tregon se shumë shpesh bashkë me kolegët kujtojnë kohërat e vjetra.

*“Po, shpesh herë me kolegët, e sidomos ato që kanë qenë ma herët. Ato ma shumë e përmendin, por edhe unë. Jo në atë kuptimin që kushtet e punës e ato nuk kanë qenë të përshtatshme, por ka qenë në qendër, ka pas ma shumë qasje për të gjitha shkollat përreth, ka pas një kopsht shumë të mirë, ku na dilshim në ballkon edhe pishim kafe bashkë”<sup>6</sup>, thotë ajo.*

<sup>6</sup> Intervistë me Fatime Mehmetaj, sekretare e Bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, dhënë për Bleona Kurteshi, 26.08.2021, Prishtinë.

Takimet në oborr nuk i kishin vetëm për të pirë kafe. Punonjësit e këtij institucioni e konsideronin atë si shtëpi të dytë. Në kohë të pranverës do të sillnin bimë të ndryshme që i mbillnin përreth. Ky lloj aktiviteti i përbashkët ia fortësoi lidhjen emocionale me vendin e punës. Ani pse secili/secila prej punonjësve ishin në kërkim të një hapësire tjetër të punës, konsiderojnë se objekti i vjetër ka peshë dhe rëndësi më të madhe. Gjithashtu edhe kur përmenden lidhjet e bibliotekistëve që kishin me lexuesit/e, duke marrë përsipër një lloj roli si të mësuesve dhe të pyesnin nxënësit nëse me të vërtetë kanë lexuar librin që ka marrë, për çka bën fjalë, apo cila pjesë u ka pëlqyer më shumë. Një lloj afërsie që thonë se tani nuk e ndjejnë.

*“Ishte një objekt modest me dikun 42 deri 44 ulëse, i ngrohtë, i qetë dhe me gjelbrim, kushtet mesatare siç janë kushtet përafërsisht në Kosovë. Unë gjithherë jam ndi aty si n’shpinë time t’dytë, ashtu edhe e kam kujt e edhe kujtimet i ruaj edhe sot - kam qenë shumë i lidhur me atë vend edhe më mungon edhe më duket se prej gjërave ma t’padrejta që i ka bërë Komuna e Prishtinës është mbyllja qoftë e përkohshme ose e përhershme e saj”<sup>7</sup>, thotë librari Bujar Verbovci.*

Fakti se ky objekt gjendet në qendër të Prishtinës, u mundësoi në veçanti nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme ta frekuentojnë më shumë, për dallim nga objekti i ri, i cili tani frekuentues më të rregullt ka studentët. Për Vjollca Tulin, objekti i vjetër krahas tjerash kishte rëndësi të madhe, pasi siç e quan ajo ishte “pikëtakim” për lexuesit.

<sup>7</sup> Intervistë me Bujar Verbovci, librar, dhënë për Goneta Ademaj, 08.09.2021, Prishtinë

*“Frekuenca e lexuesve ka qenë shumë e madhe, nuk muj me thon bash, por tash jemi sikur t’izolohem vetëm n’disa shkolla ktu, a n’biblotekën e vjetër kemi qenë në mes të qytetit dome-thonë të gjitha lagjet e kanë pasë atë qasjen n’mes me ardh, prej Vranjencit, prej Arbërisë, prej Matit 1, prej Ulpianës, prej Dardanisë, pra e kanë pasë atë pikëtakimin shumë shumë ma lehtë. Ktu tash e kemi Vranjencin, që një fëmijë duhet m’i ndrru dy autobusa me ardhë deri ktu edhe për atë na pengon ky fakt që jemi pak ma larg lexuesit, mirëpo prap ata që dojnë me lexu, lexojnë edhe vijnë.”<sup>8</sup>*

Me të njëjtën nostalgji e kujtojnë edhe ata/ato që librat e parë i lexuan në atë bibliotekë, ata që kanë ndjekur aktivitetin e tyre të parë jashtëshkollor apo edhe studentët/et që kaluan orë të tëra duke u përgaditur për provimet e tyre.

Sigurisht se për të kuptuar më qartë përshtypjet e të gjithë lexuesve/eve nëpër etapa të ndryshme do të duhej të kishte edhe përfshirje të etnive të tjera, sidomos asaj serbe, por për shkak se nuk ishte e mundur kontaktimi dhe përfshirja e tyre pasi që janë larguar nga Kosova, fokusi këtu bie në punonjësit/et dhe lexuesit/et shqiptarë/e.

Në bazë të të dhënave të gjetura nga raportet e ruajtura të punës, kuptojmë se kjo bibliotekë pati zhvillimin e saj më të madh prej gjysmës së dytë të viteve ’70, me një ndërprerje në vitet ’90, për t’u rikthyer hovshëm në vitet 2000. Stafit të bibliotekës, që atë kohë menaxhohej nga Sylejman Pireva, iu desh shumë mund dhe përkushtim që të kthejnë hapësirën në gjendje të përshtatshme për lexuesit, pasi që dëmet e shkaktuara gjatë luftës nuk ishin të vogla.

Së pari kishte mungesë të literaturës, pasi që një numër i konsiderueshëm i titujve ishte djegur ose larguar aty gjatë periudhës së masave represive të vendosura nga pushteti serb. Marrë parasysh këtu edhe vjetërsinë e objektit dhe nevojën për rinovim.

*“Po, gjithmonë e kujtoj si një vend goxha të vogël, me atë ngjyrën karakteristike të verdhë prej jashtë. Edhe shkallët kanë qenë të vjetra, kërcitshin derisa hypshe lart për me shku tek bibliotekistja. Ka qenë goxha i vjetër ama e ka pasë një ngrohtësi brenda që me krahasu me objektin e ri në Dardani, nuk më duket që e ka atë ngrohtësinë, nashta që jam mësu prej fëminisë atje e nuk më duket bash e njëjtë, edhe pse arkitektura është shumë ma e mirë edhe tash kushdo që mundet me shku ka rehati ma të madhe, karriget janë shumë ma cilësore për me lexu”, thotë Elsa Hoti, studente.<sup>9</sup>*

Megjithatë, nostalgjia karshi objektit të vjetër arsyetohet edhe më tej. Ani pse kushtet mund të mos i ketë plotësuar, kjo bibliotekë ka ditur shpeshherë të befasojë lexuesit. Sociologia Arta Sejdiu, e cila e ka frekuentuar shumë shpesh bibliotekën në kohën e studimeve, mendonte se aty do të gjente vetëm tituj të vjetër librash.

*“Nji hulumtim lidhur me të drejtat e njeriut edhe më kujtohet e pata gjete si një lloj doracakua sa i përket të drejtave të njeriut, që nuk e gjejsa kërkund tjetër përpos aty, edhe më pat ndihmu shumë. U pata habit se zakonisht biblioteka ka pasë vec ekzemplarë të vjetër.”<sup>10</sup>*

<sup>8</sup> Intervistë me Vjollca Tuli, bibliotekistë, dhënë për Bleona Kurteshi, 18.08.2021, Prishtinë

<sup>9</sup> Intervistë me Elsa Hoti, studente, dhënë për Trina Hotin, 26.08.2021, Prishtinë

<sup>10</sup> Intervistë me Arta Sejdiu, sociologe, dhënë për Trina Hotin, 27.08.2021, Prishtinë



Rruga për në bibliotekë nuk i dha vetëm pavarësinë që ajo kërkonte, por edhe shtysën që të shkruajë. Në vitin 1997, do të botonte poezinë e saj të parë në të përditshmen “Rilindja”. Poezi e cila kishte të bënte me protestat e po atij viti, dhe më pas ajo do të botohej edhe në shtete të tjera.

Çdo i ri apo e re, për t’u bërë pjesë e bibliotekës fillimisht i është dashur të anëtarësohet një formë të regjistrimit dhe më pas pajisej me kartelë për secilin libër që merrte për të lexuar. Po ashtu ky regjistrim, sipas Selvete Shalës, sekretare e bibliotekës, bëhej me një pagesë modeste.

*“Normal frymëzim për mu ka qenë Bibloteka ‘Hizvi Sulejmani’ në atë kohë sepse ka qenë institucioni i parë i librit për mu. Pasi që kam botu këtë libër, jo libër, po poezi, mas luftës meniher kam nisë intensivisht me shkru. Normal kam shku në bibliotekë, prapë te sektori për fëmijë një kohë edhe mandej jam regjistru te sektori për të rritun. Për me u regjistru te sektori për të rritun atëherë e kam botu librin tem të parë, 2004 kam qenë në shkollë të mesme edhe kam fillu me hi me njëfarë rrethi të shkrimtarëve të rinj”, shton ajo.<sup>12</sup>*

*“Pagesa ka qenë minimale, domethanë ajo pagesë ka qenë as për shërbimet që janë ba të letrës se le ma shumë. Ka qenë 2 euro, e di që pagesa e parë për fëmijë 2 ose 3, e 5 për të rritun. Pagesë në vit domethënë, modeste, shumë modeste vetëm sa mu ditë. Shumicën e kategorive të lexuesve i kemi pas pa pagesë, ai që s’ka pasë mundësi me pagu ose kategoritë si edhe sot që janë me ndihma sociale, kategori të ndryshme që janë disa kategori pa pagesë”, thotë ajo.<sup>13</sup>*

## BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE “HIVZI SULEJMANI” - PRISHTINË

LIBREZA E ANËTARËSISË

Nr. \_\_\_\_\_ Viti \_\_\_\_\_

Spektori-Dega \_\_\_\_\_

Mbiemri \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_

Profesioni \_\_\_\_\_

Adresa (tel.) \_\_\_\_\_

Nr. idok. të identifikimit \_\_\_\_\_

**Nga Rregullorja mbi shfrytëzimin e fondit bibliotekar:**

- Libri jipet në shfrytëzim më së shumti për 15 ditë, por me të drejtë vazhdoni pas konsultimit
- Për librin e vonuar pas këtij afati bëhet kompenzimi
- Libri i dëmtuar apo i humbur kompenzohet me të njëjtën libër ose vlerë të trefishtë
- Informatat e tjera merren nga librat bibliotekës.

ÇMIMI \_\_\_\_\_ €

Tel: 038/232-980

038/245-523



<sup>12</sup> Ervina Halili, poete, intervistë dhënë për Egzona Hajrullahu, 09.09.2021, Prishtinë

<sup>13</sup> Intervistë me Selvete Shala, sekretare e bibliotekës, dhënë për Ridona Berisha, 05.10.2021, Prishtinë.



Afati i kthimit	Numri i inventarit	Data e kthimi	Nënshkrimi i librarit

Objekti i ish- Bibliotekës, ani pse gjendet i fshehur në rrugicë në lagjen Tophane në Prishtinë, gjithsesi në kujtesën e të gjithëve mbetet si pikëtakim i lexuesve dhe adhuruesve të librit. Sidomos për banorët e lagjes kishte një kuptim tjetër dhe ishte pikë reference veçanërisht për fëmijët e lagjes që u rritën afër bibliotekës. Shumë lexues kujtojnë rendet e gjata të nxënësve që prisnin për të hyrë brenda ose për të lexuar ose për të marrë librin e preferuar. Gjithmonë duke i ndenjur gati afatit të regjistrimit dhe posedimit të kartelave të librave. Regjisorja kosovare Lendita Zeqiraj, është një prej atyre që pati fatin të jetojë afër bibliotekës.

*“Procesi ka qenë me një dokument m’doket, me një letërnjoftim që ish me marrë në lagje që je banorë i lagjës edhe momentin që e ki atë letrën si banorë i lagjës ish regjistrim si çdo regjistrim tjetër, domethanë n’këtë katin e parë m’duket ish regjistrimi, mandej n’katin e dytë ish biblioteka për një moshë t’caktume. Ka qenë shumë e strukturume, ka qenë mirë edhe bibliotekistet nuk m’kujtohen emrat, vetëm e di që dukeshin sikur t’ishin biblioteksite t’kohës sime domethanë t’paraluftës me atë moshë me atë stilin edhe t’veshjes edhe një kulturë një që me heshtje me pak fjalë kryheshin punët, e ton ata fmijë që ishin n’sallat t’shkepun n’salla t’vogla t’leximit”, thotë ajo.<sup>14</sup>*

<sup>14</sup>Intervistë me Lendita Zeqiraj, banore e lagjes, dhënë për Ridona Berisha, 18.08.2021, Prishtinë

SINIALE

## Kthimi në biblioteka

**Përpunimi i veprimtarisë bibliotekare është një nga kushtet e zhvillimit në shoqëri. Bibliotekat, të jenë, një nga vendtëkëmbet e qytetarëve...**

librat në numër të caktuar njësisë. Në shumë biblioteka mund të huazohen vetëm libra të botuar dhe të shtetit, vjetër me parë, madje kryesisht botime që afirmojnë angazhimin politik të shtetit në të gjitha bibliotekat. Jo rrallë, ndodh edhe ndonjë veprim qytetar për t'u përmirësuar individual apo i përbashkët, që solidarizohet në bërjen e tashmë të rinj e atyre me vlerë, që u dedikohen bibliotekave në fshat apo në shkollë. Dhe, pikërisht këto biblioteka, shkollore dhe të fshatit, mund të jenë më të përshatshmet për t'u përpunuar

veprimtaria bibliotekare, përkatësisht të shtetit, fondi i tyre librar dhe të rritet numri i lexuesve. Shfrytëzimi në masë sa më të madhe i sallave të rrethuar sistematikisht nga më të ndryshmet, aksesit një çekullibrim i këllitë nuk do të duhej të përfundonte në gjendje amorfë. Përkundrazi, janë gjendjet e krijuara në shoqëri, ato të cilat vënë në lëvizje natyrën kërkimore të njeriut. Aq më tepër, atëherë kur kriza reflekton nga shtypjet politike. Si rrjedhim është i domosdoshëm angazhimi intelektual për avancimin e të gjitha segmenteve të jetës, pra edhe të kulturës.

Nuk mund të merret me mend një përpunim individual-kolektiviteti, pa pasur një rrjet të zhvilluar të veprimtarisë bibliotekare. Edhe pse biblioteka më me rëndësi në Kosovë, Biblioteka Popullore dhe Universitare në Prishtinë, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e saj, për shkak të vënies nën masë të dhunashme nga viti 1990, pra e mbyllur për lexuesin dhe kolektivin shqiptar, megjithëkëtë është e domosdoshme që lexuesi të orientohet në shfrytëzimin e lokaleve të bibliotekave të tjera. Rrjeti i bibliotekave në Kosovë ka rreth 600 biblioteka, pra një kapacitet i cili duhet shfrytëzuar, edhe pse në shumë sosh është vepruar me metoda të njëjta, shoviniste. Janë demtuar fondet e librit dhe është ndërprerë puna në sistemin e librit në biblioteka. Porse, një nga veprimet, më të dëmshme është mbejta e fondit

Shpend HALIL

Një libër mund të mbahej në posedim për dy javë dhe pastaj duhej kthyer prapë në bibliotekë, gjithmonë duke u kujdesur sa më mirë që të mos dëmtohej. Në një periudhë kohore bibliotekistët madje kishin nisur të luajnë edhe rolin e mësueses/it. Kur fëmijët kthenin librat ato/ata i kërkonin atyre të përshkruanin shkurtimisht se çka i ka lënë mbresa rreth librit. Kjo shihet si mënyrë për të inkurajuar dhe shtyrë lexuesit që të lexonin më shumë dhe njëkohësisht për t'u dhënë mundësi të kuptojnë më shumë. Shpeshherë propozonin tituj të ndryshëm që konsideronin se duhet të lexoheshin.

Biblioteka "Hivzi Sulejmani", nuk ishte pikëtakim dhe pikë reference vetëm për banorët e lagjes, por edhe për të gjithë ata/ato nxënës/e e studentë/e që shfrytëzuan sallat e leximit dhe literaturën që gjendej në dispozicion, varësisht prej periudhave kohore dhe rrethanave politike e sociale. Hapësira gjeografike ku gjendet objekti, mund të shihet edhe si një pikë e mirë strategjike pasi qëndron në mes disa prej lagjeve të Prishtinës që kishin banorë të etnive të ndryshme. Prandaj, nuk kishte se si edhe biblioteka të mos shërbente për të gjitha komunitetet e ndryshme që kanë jetuar në lagje dhe rrethinë, pra kishte një dimension multi-etnik. Përveç literaturës në disa gjuhë të ndryshme, zhvilloheshin edhe aktivitetet e tjera që mblidhnin grupe të etnive të ndryshme në një vend.

Krahas shërbimeve bibliotekare për lexuesit, udhëheqësia e re, në fillim të viteve 2000 nisi përpilimin e programeve të tjera që do të përplotësonin aktivitetet e bibliotekës. Ky institucion arriti të krijojë shumë mundësi mësimi e argëtimi për lexuesit e vetë. Aktivitetet që janë organizuar në bibliotekë përgjatë kësaj periudhe përfshijnë një gamë të gjerë si: organizimi i garave të shkrimtarëve, themelimi i Klubit Letrar i të Rinjëve, publikimi i revistës letrare “OAZA”, publikimi i librave të shkruar nga pjesëtarët e klubit, bashkëpunimi me Karavanin e Shkrimtarëve për Fëmijë për nder të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë etj.

Liljana Lokaj, tregon se si biblioteka ka shënuar ditë të ndryshme me aktivitete të shumta.

*“Dita e librit, sidomos 2 prilli, dita ndërkombëtare e librit për fëmijë që ka filluar prej vitit 2002, ku ende sot mbahet nga një aktivitet për këtë ditë. Kjo është dita ndërkombëtare e librit për fëmijë edhe krejt bota e feston. Dmth jepet një mesazh nga një shtet, mesazh ky që lexohet në të gjithë botën atë ditë. Mandej, në bibliotekë këtu organizojmë aktivitete tjera, e shfaqim konkursin për ese. Këtë konkurs e shpërndajmë nëpër shkolla, dhe shpallen tre punimet më të mira që i kanë shkru ata nxënës. Ditë festive që i kemi pasë, për shembull dita e mësuesit 7 Marsi, 8 Marsi, mandej 28 Nëntori, ka pasë, ka pasë festa. Kemi punu me fëmijë nuk është veç që kemi dhanë libra, me ardhë e me shku si n’dyqan kur i blen përshembull gjanat e me dalë, jo. Unë kur kam punu, njëzet e tri vite kom punu edhe në bibliotekë n’shpi t’Hivzi Sulejmanit, unë e kom qelë atë bibliotekë.*

*Dy salla të mrekullueshme. Atje na maspari, biblioteka e përrallave atje ia ka nisë punën me parashkollorë, se as nëpër shkolla nuk ka pasë, atë periudhë kurë nuk e harroj. Kemi pasë 70 fëmijë, dy salla plot, kemi punu, çdo ditë kanë pasë aktivitete të ndryshme”<sup>15</sup>, thotë ajo.*

Po ashtu u organizuan ekspozita të artit, u krijuan dhomat e internetit që mund të shfrytëzoheshin nga lexuesit, derisa u krijuan bashkëpunime me bibliotekat në Zarë, Durrës dhe Preshevë. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i kësaj biblioteke është edhe ndarja e çmimit “Lexuesi i vitit”, që i jepej atij/asaj që brenda një viti kalendarik ishte më aktivi/ja. Gjithashtu janë organizuar takime me lexues të rinj, dhe janë krijuar bashkëpunime me shkolla fillore dhe të mesme. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të stafit, kjo bibliotekë organizoi edhe trajnime të ndryshme profesionale.

*“Domethanë i kena pasë aktivitetet edhe tradicionale që kanë qenë çdo vit që përshembull shpallja e lexuesve të vitit. Ka qenë shumë bukur, një organizim fort i mirë ku të gjithë u angazhojshim kur kishim organizime të ndryshme, shumë bukur ka qenë, i kena thirrë mediat kanë shku edhe përmes mediave edhe shtypit edhe përmes institucioneve domethanë vartëse, relevante çka janë organizata të ndryshme i kena thirrë, kanë marrë pjesë”<sup>16</sup>, rrëfen Selvete Shala.*

Gjithë këto aktivitete ndihmuan në formësimin e shumë nxënësve dhe studentëve të rinj/reja, sidomos në fushën e letërsisë. Biblioteka përveç shërbimit të librave, me aktivitetet e veta u bë pjesë e pandashme e shumëkujt që ishte i/e etur për të krijuar diçka më shumë. Një prej tyre, pa dyshim është edhe revista letrare “Oaza” e cila kontribuoi në daljen në pah të shumë shkrimtarëve/eve të rinj/reja në atë kohë, të cilët edhe sot vazhdojnë krijimtarinë e tyre letrare.

<sup>15</sup> Intervistë me Liljana Lokaj, ish-bibliotekiste, dhënë për Goneta Ademaj, 18.08.2021, Prishtinë.

<sup>16</sup> Intervistë me Selvete Shala, sekretare e bibliotekës, dhënë për Ridona Berisha, 05.10.2021, Prishtinë.





Në Kosovën e pasluftës, sidomos në vitet e para drejt shtet-formimit dhe rimëkëmbjes shoqërore, ekonomike, politike, çdo proces ishte i rëndë. Megjithatë ekzistonte një gjendjeje stabiliteti, sikur gjithçka po niste nga e para. Ndonëse për shumë aspekte ashtu ishte. Sistemet shtypëse për vite me radhë drejtuan formën e të menduarit dhe qasjes ndaj çështjeve të ndryshme, duke cenuar shumë shpesh edhe rrjedhën e të shkruarit apo krijuarit. Nëse marrim si shembull format krijuese siç është letërsia, atëherë është e qartë se edhe forma shprehëse do t'i përkiste momentumit të asaj periudhe, dhe çështjeve relevante të kohës, dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet si letërsi e angazhuar. Revista letrare "Oaza" mëtonte të mundësonte kësaj një formë tjetër të shprehjes, si një çlirim më vete.

Ose të paktën këtë thirrje bënin redaksia e revistës, se "tash duhet të fillojë epoka e 'normalitetit', kur duhet të kuptohet që roli i letërsisë në krijimin e identitetit kombëtar, historisë kombëtare dhe udhëheqjes së luftërave çlirimtare ka kryer punën e vet dhe letërsia duhet t'i kthehet artit të shkrimit."<sup>17</sup>

Themelimit të kësaj reviste i parapriu një aktivitet shumë i rëndësishëm për Bibliotekën. Në prill të vitit 2003 do të formohej Klubi Letrar i të Rinjve, i cili arriti të mbledhë rreth 40 anëtarë. Pas tre muajsh takime e punë, Biblioteka arriti ta botojë përmbledhjen e parë me poezi, me titullin "Ta dëgjoj jetën", duke u bërë kështu botimi i parë në historinë e këtij institucioni. Ky botim i parapriu edhe tetë librave të tjerë me poezi, prozë e publicistikë. Megjithatë si një prej arritjeve më të mëdha në këtë aspekt konsiderohet botimi i parë i revistës letrare "Oaza", e cila doli në vitin 2004, një vit pas formimit të Klubit.



Në gazetë ditore, siç edhe ishte zakon, publikoheshin konkurset, fillimisht për poezi, tregim dhe ese/kritikë, më pas për t'u shtuar edhe drama. Për përzgjedhjen e tyre u kujdes një juri e krijuar nga Klubi me emra të shkrimtarëve të njohur, derisa aplikantëve u kërkohesh që të dorëzonin materialin me shifra në vend të emrave.

Shkrimtari dhe studiuesi i letërsisë Gëzim Aliu, shpjegon se si ka qenë procedura e aplikimit, kur edhe vet kishte konkuruar në vitin 2005.

*“Qysh u bo shpallja për me apliku, u bo shpallja edhe e fituesve në gazetë, edhe unë e marr me vonesë gazetën edhe e shoh që shpërblimi i parë ju ka dhanë tregimit ‘Kokrra e zezë’ kodi 77.[shkruante] i lusim autorit të paraqitet. A unë shkoj me vonesë. Hera e parë që shkoj në bibliotekë të qytetit aty, se jemi shpërbly me çmimin e parë, edhe me të vërtetë mu dok interesant objekti se ai është pak i fshehur mes objekteve socialiste.”<sup>18</sup>*

Tregimi i tij “Kokrra e zezë”, njëherësh është zanafilla e romanit të tij “Në klubin e të shëmtuarve”, i botuar në vitin 2009 dhe po atë vit mori çmimin si romani më i mirë i vitit. Aliu më pas u bë redaktor i revistës letrare dhe rreth vetes kishte anëtarë të tjerë të Klubit Letrar për të Rinj, i cili më vonë mori emrin “Klubi Letrar Prishtina”. Ani pse ky klub barti emrin “Klubi Letrar Prishtina”, nuk ishte i kufizuar vetëm për prishtinasit/et. Përkundrazi, klubi kishte në përbërje individë të cilët/cilat vinin nga vende të ndryshme të Kosovës, si dhe studentë që kishin ardhur në Prishtinë për të studiuar.

Ag Apolloni, Ervina Halili, Adil Olluri, janë disa prej anëtarëve të Klubit, sot shkrimtarë e poetë të njohur, të cilët po ashtu publikuan në revistë shkrimet e tyre. Ky Klub u hapi dyert ose i inkurajoi shumë krijues të rinj që të vazhdojnë më tutje me shkrimet, poezitë, kritikën e tyre, për faktin se ato botoheshin në revistë. Por edhe për arsye të tjera, Klubi për dikë kishte rëndësi edhe më të thellë. Duke qenë se bëhet fjalë për vitet e para të pasluftës, ishte e natyrshme që atmosfera e punës të mos ishte e zakonshme. Për Ollurin, ky aktivitet dhe kjo revistë kishin kuptimin e strehës.

*“Për atë kohë u kanë pyetje e zakonshme edhe ‘a jeni t’humbur, a ju mungon dikush?’. Edhe atmosfera u kanë qishtu a din, hala nën ethe se çka po ndodhë me neve, edhe n’atë kohë me gjetë një vend si Oaza, se kjo u kanë edhe si oazë e qetësisë. Si oaza ku veç shkon e lexon edhe menon për letërsi, e për kulturë e kështu, se u kanë edhe si lloj ndikim i mirë psikologjik për të rinjtë”<sup>19</sup>, thotë ai.*

“Oaza”, për 5 vite botoi nga dy revista në vit dhe shpallja e fituesve bëhej me rastin e “Javës së Bibliotekës”, aktivitet ky që organizohet nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”. Në vitin 2008 ishte propozuar që në vitet e radhës fituesit të shpalleshin me 23 prill, në Ditën Botërore të Librit. Por ky ishte viti i fundit i botimit të revistës. Ndryshimi i udhëheqësisë së bibliotekës po atë vit mund të ketë qenë një prej arsyeve, por në anën tjetër edhe kushtet ekonomike dhe mbështetja e vogël për botime të tilla.

Në fjalinë hyrëse në numrin e pestë të revistës, Pireva shkruante:

Pavarësisht arsyes së ndaljes së botimit të revistës, ajo mbetet prapë një material i cili dokumenton një formë të re të shprehjes letrare, dhe si urë lidhëse për shumë shkrimtarë/e e poet/e të cilët sot janë emra të njohur në krijimtarinë letrare në Kosovë. Pa dyshim se, ashtu siç thotë gazetari Imer Topanica, “fakti që nëpërmjet kësaj reviste janë promovuar një brez i tërë shkrimtarësh, poetësh e kritikësh, e shpjegon rëndësinë e saj.”<sup>21</sup>

*“Na vjen keq, por për mungesë të mjeteve buxhetore që nuk i disponon Biblioteka dhe për mungesë përkrahjeje nga institucionet qeveritare, nuk kemi arritur që të botojmë më shumë se dy numra në vit të revistës dhe që asnjëherë të vetme t’ua paguajmë honorarët autorëve, gjë që do të ndikonte shumë më tepër në motivimin e tyre për angazhim më të madh dhe për ngritjen e cilësisë së revistës.”<sup>20</sup>*

<sup>20</sup> Fjala hyrëse e Syljeman Pireva, revista letrare “Oaza”, 23.04.2008, Prishtinë, fq.73.

<sup>21</sup> Intervistë me Imer Topanica, dhënë për Bleona Kurteshi, 16.09.2021, Prishtinë

Objekti në një hapësirë prej 30 hektarësh, projekt i cili kishte nisur në vitin 2011, pas shumë shtyerjesh të punëve dhe vone-save fillimisht me rishikimin e objektit e më pas me blerjen e inventarit, tani strehon bibliotekën më të madhe të Prishtinës, Bibliotekën “Hivzi Sulejmani”. Me 23 gusht të vitit 2016 u hap solemnisht për lexuesit e rinj dhe jo vetëm. Kjo konsiderohet data zyrtare e punës në objekt të ri, derisa muaj më parë ishte zbrazur dhe braktisur objekti ku kjo bibliotekë kishte funksionuar për gati 70 vjet.

Viti 2016 gjithashtu shënon një fazë të re për objektin e vjetër, fati i të cilit ishte i vështirë për t'u përcaktuar. Më 21 prill të vitit 2017, Kuvendi Komunal i Prishtinës miratoi propozimin për rifunksionalizim të tanimë ish-bibliotekës. U propozua që të shndërrohej në muze, po jo çfarëdo muzeu. Do të barte emrin Muzeu “Ibrahim Kodra”, derisa parashihej që aty të ekspozoheshin mbi 100 vepra të mjeshtrit që njihet edhe si kubisti i fundit. Ky muze do të funksiononte si degë e muzeut të qytetit, por për ta bërë një gjë të tillë Komuna e Prishtinës fillimisht do të duhej të themelonte

Muzeun e Prishtinës. Në vitin 2018 fondacioni “Ibrahim Kodra”, me kryesuese Maria Pacolli dhe ish-kryetari i Prishtinës Shpend Ahmeti, nënshkruan një memorandum për nismën e këtij projekti. Një projekt ideor për shndërrimin e objektit, i cili është monument dhe nën mbrojtje, ishte përpjekja e parafundit për rifunksionalizim. Sipas Institutit Kosovar për Mbrojtje të Monumenteve ky plan nuk i përmbahej rregullave dhe ligjeve për monumente dhe konsiderohej se i njëjti do të dëmtonte pamjen origjinale të objektit.

E gjithë kjo punë dhe përgaditje dy vjeçare nuk u realizua dhe shpresat që objekti të funksionalizohej u shuan. Këtu edhe filloi degradimi më i madh i objektit. Punonjësit e bibliotekës kishin marrë me vete vetëm librat dhe dokumentet, duke lënë prapa inventarin dhe gjithçka tjetër që konsiderohej e vjetër.

Kopshti me shumë gjelbërim që gjithmonë e karakterizonte këtë hapësirë mbeti pa përkujdesje, njëjtë sikur e gjithë hapësira. Për një periudhë madje edhe u përdor nga persona të panjohur të cilët besohet se mund t'i kenë shfrytëzuar hapësirat e objektit

edhe për veprime jo ligjore.

Një përpjekje tjetër për të ringjallur këtë objekt ndodhi në vitin 2020. Komuna e Prishtinës hartoi një detyrë projektuese për ruajtjen, restaurimin dhe adaptimin e objektit në galeri të qytetit. Po ashtu kishte krijuar një Konkurs Arkitektonik, që të shndërrohet në galeri të qytetit të Prishtinës dhe në rezidencë artistësh, “institucion ku artistët vendorë dhe ndërkombëtarë mund të shprehin kreativitetin e tyre dhe njëherit t'i ekspozojnë ato punime”.

Komuna e Prishtinës gjatë procesit të hartimit të kësaj detyre projektuese mbajti takime të ndryshme me artistë/e dhe organizata të artit dhe kulturës, ku u diskutua më shumë rreth jetësimit të objektit në galeri. Gjatë këtyre takimeve janë dhënë ide e propozime të ndryshme për të kontribuar në një proces i cili nuk u realizua. Në konkursin e shpallur nga Komuna e Prishtinës, ishin tre projekte ideore që aplikuan, por asnjëra prej tyre nuk kaloi. Edhe kësaj radhe parametrat e propozuara nuk përkonin me rregullat dhe ligjet

për mbrojtje të monumenteve, dhe IKMM-ja i anuloi të treja projektet. Pas dështimeve të njëpasnjëshme të këtyre proceseve, sipas ish-drejtorit të Drejtorisë së Kulturës në Komunën e Prishtinës, Adrian Berisha, zgjidhje e duhur u konsiderua që ky objekt t'i jepej Manifesta 14 në shfrytëzim.

*“Ne kemi propozuar që njëri kat me qenë galeri, e kati i dytë për rezidenca të artistëve. Ky ka qenë propozimi që na kemi diskutu me e bo. Por pastaj kur Manifesta ka ardh dhe ka dashtë me e bo qet institucionin, ka qenë një diskutim mes neve dhe tjerëve se çka duhet me bo qaty. Ka qenë një detyrë projektuese e cila është bërë në bashkëpunim me rekomandimet që i kemi marrë prej komunitetit në përgjithësi dhe i kemi pranuar tri projekte të ndryshme për me intervenu aty. Të tri projektet nuk kanë kalu në Institutin Kosovar për Mbrojtje të Monumenteve edhe në qato momente në diskutim me Manifestën e kemi mendu që është mirë me kriju një institucion aty çfarë mendon Manifesta, duke e marrë parasysh ekspertizën e Manifestës”<sup>22</sup>, thotë ai.*

<sup>22</sup> Bisedë me Adrian Berisha, ish-drejtor i Drejtorisë së Kulturës në Komunën e Prishtinës, dhënë për Sihana Klisurica, 23.03.2022, Prishtinë



Biblioteka “Hivzi Sulejmani”, si institucion kulturor, edukues e informues vazhdon punën edhe në një objekt tjetër, por kur përmendet emri i këtij institucioni shpesh aludohet për ish-objektin në Tophane. Gjenerata të tëra fëmijësh në Prishtinë i kanë kujtimet e tyre të para me librin pikërisht në këtë objekt. Por jo vetëm fëmijët. Përkundër gjithë sfidave që punonjësit mund të kenë pasur në këtë objekt, dhe përkundër hapësirave të vogla për lexim, prapë mbetet si një oazë, fshehur në një rrugicë që ka mirëpritur gjithë adhuruesit e librit.

Prej vitit 2016 në qarqe të caktuara është diskutuar fati i këtij objekti, por kryesisht në media pas marrëveshjeve që të kthehet në Muzeun “Ibrahim Kodra”. Sidoqoftë, diskutimi për këtë objekt do të duhej të ishte edhe më i madh dhe më i zëshëm. Fatkeqësisht nuk është monumenti i parë, apo objekti i parë që mbrohet me ligj, i cili lihet anash. E më keq edhe të dëmtohet. Pas largimit të bibliotekës objekti mbeti pa mbikëqyrje.

Ndonëse i lënë anash nga akterët që kanë obligim ligjor të kujdesen për të, ky objekt mbetet i ngulitur në kujtesën e gjithësecilit/ës, edhe nëse e ka vizituar vetëm një herë.

Për ata/ato që punuan aty, ata/ato që u rritën pranë tij, apo edhe lexuesit e shumtë, ky objekt duhet të kthehet në bibliotekë. Rreth 80% e të intervistuarve për këtë hulumtim, kërkojnë apo dëshirojnë që në një formë apo tjetër, t'i kthehet funksioni që kishte. Ndërsa të tjerët janë dakord me cilindo funksion që do të mund të marrë, për aq kohë sa nuk do të qëndrojë i braktisur.

Sekretarja e Bibliotekës, Fatime Mehmetaj tregon se si pothuajse gjithë stafi ka kërkuar që në objektin e vjetër të rimarrë funksionin që ka patur.

*“Ne kemi kërkuar nga drejtorja për kulturë që ajo pjesa e ndame, salla që është e ndërtime ma vonë, me mbet si degë e jona për fëmijë. Pra me pas literaturë për fëmijë, me pas qasje edhe fëmijët aty dhe shkollat që i kemi pas afër. Ajo sallë ka qenë e ndërtuar më vonë, ka pas hapsirë dhe drita, i ka pas 44 ulëse. Nuk e di për çka mundet me shërby edhe pse nuk është fort i përshtatshëm, por ndoshta me investu kogja mirë në to, ai objekt kish mujt me u përdorë, ndoshta qendër kulturore. Njëherë u fol që do të bahet ekspozita e Ibrahim Kodrës. Nuk e di në çfarë gjendje osht.”<sup>23</sup>*

Duke parë mungesën e bibliotekave në qytet, ose nevojën për më shumë hapësira sidomos për nxënësit, Drita Toci, ndan po ashtu mendimin se objekti duhet të jetë bibliotekë.

*“Patjetër që po, patjetër që po se është domosdoshëm jo vetëm në atë pjesë të qytetit po edhe nëpër shumë vende, lagje të qytetit bile mini biblioteka me ekzistiu, se tu e marrë parasysht prej qendrës ku është për shembull Skënderbeu e në atë pjesën deri n’Vranjevci atje, ajo pjesë e qytetit e ka larg në Dardani me ardhë, tash ne jemi dominu prej studentave nuk di nuk muj me i thanë kësaj bibliotekë e qytetit ma, kjo gati gati ka marrë kuptimin e bibliotekës universitare, s’është me rëndësi kjo periudhë për intervistën por ai objekt është dashur me funksionu prapë, me u renovu, me u rregullu, me investu kush mundet me pasë atë përgjegjësi”<sup>24</sup>, thotë ajo.*

Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm në këtë mes, përveç tjerash, është edhe fakti se ky objekt ka shërbyer si strehë e gjithë komuniteteve që jetonin dhe jetojnë në Prishtinë. Duke qenë se në Kosovë bashkëjetojnë komunitete të etnive të ndryshme, me shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq, goran, romë

(shpesh të grupuara me ashkalinjtë dhe egjiptianët), ky diversitet është vërejtur deri diku edhe në bibliotekë. Sidomos në dekadat e para të punës së saj. Gulsen Bolukbasi, një prej banoreve të lagjes është një prej shembujve që e vë në pah këtë aspekt.

*“Prej krejt atyne kujtimeve që i kom pas në bibliotekë, dëshiroj që në të ardhmen me pa atë pjesën që e promovon bashkëjetesën në mes të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, duke përfshirë aktivitete në të gjitha gjuhët të folura në Kosovë. Ne jemi rrit duke mësuar gjuhën e njoni-tjetrit prej moshës së vogël. Unë nuk kom shku në gjuhën shqipe asnjë ditë në shkollë, kom shku në gjuhën turke. Gjuhën shqipe e kom mësu vet, fillimi ka qenë prej atij oborrit në bibliotekë që kemi pas aty, së bashku me shoqet e shokët, shqiptarë, boshnjakë etj. Secili prej nesh e ka mësuar dhe respektuar gjuhën dhe kulturën e njoni-tjetrit”<sup>25</sup>, thotë ajo.*

Të tjerë, që duan ta shohin objektin funksional, u mjafton fakti që të ketë aktivitet aty dhe të mos mbetet i tillë siç është momentalisht. Apo të paktën të ketë të bëjë me librin. Flora Brovina, shkrimtare, politikane dhe aktiviste, e cila po ashtu kaloi fëmijërinë e saj në këtë bibliotekë, ka kujtime të shumta aty që vlerëson se ato duhet të ruhen, sepse “muret e objektit nuk janë biblioteka ose historia e bibliotekës nuk është biblioteka, janë librat që duhet të jenë aty dhe të jenë shumë të kujdesshëm për jetëgjatjen e tyre.”<sup>26</sup>

Dëshirat në lidhje me objektin drejtohen tek të qenurit një hapësirë sociale dhe kulturore, muze i librit apo edhe hapësirë multifunkionale në shërbim të të rinjve e të rejave. Një hapësirë që kontribuon në zhvillim dhe rritje personale, po ashtu për aktivitete jashtë shkollore.

<sup>23</sup> Intervistë me Fatime Mehmetaj, sekretare e bibliotekës, dhënë për Bleona Kurteshi, 26.08.2021, Prishtinë.

<sup>24</sup> Intervistë me Drita Toci, bibliotekistë, dhënë për Goneta Ademaj, 18.08.2021, Prishtinë.

<sup>25</sup> Intervistë me Gulsen Bolukbasi, dhënë për Bleona Kurteshi, 03.11.2021, Prishtinë

<sup>26</sup> Intervistë me Flora Brovina, shkrimtare dhe aktiviste, dhënë për Trina Hoti, 07.09.2021, Prishtinë

## BIBLIOGRAFIA:

## MATERIALE BURIMORE:

1. Aliu, Gëzim, Revista Letrare "Oaza", Biblioteka "Hivzi Sulejmani", Prishtinë, 2008
2. Berisha, E., 2021. Nisma për heqjen e emrit të Hivzi Sulejmanit nga biblioteka, ndan letrarët. [online] KOHA.net. E qasshme në <https://www.koha.net/kulture/253970/nisma-per-heqjen-e-emrit-te-hivzi-sulejmanit-nga-biblioteka-ndan-letrarët/>
3. Biblioteka-pr.org. 2016. Historiku. [online] E qasshme në: <https://www.biblioteka-pr.org/sq/Historiku>
4. Galica, "Për librin të mendohet seriozisht", Gazeta Bujku, Prishtina 1991.
5. Halili, Shpend, "Kthimi në biblioteka", Gazeta Rilindja, Prishtina 1996.
6. Pireva, Sylejman, Biblioteka Publike "Hivzi Sulejmani" (1945-2010), 2011, Prishtinë
7. Pireva, Sylejman, Revista Letrare "Oaza", Biblioteka "Hivzi Sulejmani", Prishtinë, 2008
8. Sadiki, Arbër, *Arkitektura e Ndërtesave Publike në Prishtinë: 1945-1990, Faktorët shoqëror dhe formësues*, 2020, Prishtinë, NTG Blendi, 2020

## INTERVISTA:

1. Aliu, Gëzim, intervistuar nga Idila Ibrahim, Prishtinë, 02.09.2021
2. Brovina Flora, intervistuar nga Trina Hoti, Prishtinë, 07.09.2021
3. Bolukbasi, Gulsen, intervistuar nga Bleona Kurteshi, Prishtinë, 03.11.2021
4. Halili, Ervina, intervistuar nga Egzona Hajrullahu, Prishtinë, 09.09.2021
5. Hoti, Elsa, intervistuar nga Trina Hoti, Prishtinë, 26.08.2021
6. Lokaj, Liljana, intervistuar nga Goneta Ademaj, Prishtinë, 18.08.2021
7. Mehmetaj, Fatime, intervistuar nga Bleona Kurteshi, Prishtinë, 26.08.2021
8. Olluri, Adil, intervistuar nga Idila Ibrahim, Prishtinë, 20.09.2021
9. Shala, Selvete, intervistuar nga Ridona Berisha, Prishtinë, 05.10.2021
10. Sejdiu, Arta, intervistuar nga Egzona Hajrullahu, Prishtinë, 27.08.2021
11. Toci, Drita, intervistuar nga Goneta Ademaj, Prishtinë, 18.08.2021
12. Topanica, Imer, intervistuar nga Bleona Kurteshi, Prishtinë, 16.09.2021
13. Tuli, Vjollca, intervistuar nga Bleona Kurteshi, Prishtinë, 18.08.2021
14. Verbovci, Bujar, intervistuar nga Goneta Ademaj, 08.09.2021, Prishtinë
15. Zeqiraj, Lendita, intervistuar nga Ridona Berisha, Prishtinë, 18.08.2021

## FALENDEROJMË GJITHASHTU TË INTERVISTUARIT/ET:

Adriatik Zeqiri, Afërdita Kurshumliu, Arbër Salihu, Bajram Aliu, Bajram Ismaili, Bekim Cakolli, Berat Dakaj, Bujar Sadiku, Fatmir Krasniqi, Fegjrie Kuleta, Gresa Statovci, Ilfane Gashi, Ilir Berisha, Isa Vatovci, Jeton Kelmendi, Luljeta Avdiu Jashari, Luljeta Avdiu, Lumturije Krasniqi, Mahmut Breca, Makfret Abdullahu, Mensur Humolli, Mimoza Hasani Pllana, Mirsada Sulejmani, Munish Hyseni, Naim Sejdiu, Shqipe Pacolli, Sylejman Pireva, Tringë Sokoli, Valbona Habipaj, Vilson Culaj, Zanita Halimi, Zithane Ulaj.



Kujtesa kolektive për (ish) Bibliotekën  
“Hivzi Sulejmani”  
Projekt nga programi i Edukimit dhe Ndërm-  
jetësimit të Manifesta 14

Projekti kërkimor i zbatuar nga:  
Fondacioni Shtatëmbëdhjetë dhe  
Ekipa e Edukimit dhe Ndërmjetësimit të  
Manifesta 14

Autore e raportit: Sihana Klisurica

Hulumtueset: Bleona Kurteshi,  
Egzona Hajrullahu, Goneta Ademaj,  
Idila Ibrahim, Trina Hoti, Ridona Berisha,  
Lirika Demiri

Mentore të hulumtimit:  
Nita Luci dhe Linda Gusia

Dizajni: Qëndresa Zeka  
Këshillues Dizajni: Bardhi Haliti

Përkthimi nga gjuha shqipe në gjuhën an-  
gleze: Besnik Thaqi

Redaktimi në gjuhën angleze:  
Jack Butcher

Lektorimi në gjuhën angleze:  
Anna Thornton

Lektorimi në gjuhën shqipe:  
Blerina Kanxha

Departamenti i Edukimit dhe  
Ndërmjetësimit të Manifesta 14

Yana Klichuk  
Udhëheqëse e Edukimit dhe  
Ndërmjetësimit

Erleta Morina  
Kordinatore e Edukimit

Kordinatore e Publikimeve ]  
të Manifesta 14  
Rina Krasniqi

Shtypi: Shtypshkronja Iliri

Prishtinë, Maj 2022

# Manifesta 14 Prishtina 2022

BIBLOTEKA "HIVZI SULEJMANI"  
PRISHTINË - PRISTINA  
Sektor, dega 7 Jemrijeve  
Nr 18408-20

manifesta°



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo  
Qeveria / Vlada / Government  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministère de Culture, Jeunesse et Sport  
Ministry of Culture, Youth and Sport

LUXEMBOURG  
AID & DEVELOPMENT



17

